

**AKT-THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**VEGA ENGINEERING**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "VEGA ENGINEERING" Sh.p.k, e përbërë nga:

- BRUNO PAPAJ**, person fizik, shtetas Shqiptar i lindur më datë 09.10.1993, në Fier, Shqipëri dhe banues në Tiranë identifikohet nëpërmjet pasaportës me nr. BJ9879290, me zotësi të plotë për të vepruar.
- PHILIPP KORONOWSKI**, person fizik, shtetas Gjerman, i lindur më datë 04.04.1996, Wuppertal, Gjermani dhe banues në Aachen, Gjermani identifikohet nëpërmjet pasaportës me nr.C6ZZ3ZYFF me zotësi të plotë për të vepruar.

Në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe bazuar në dispozitat e legjisacionit Shqiptar, vendosen të hartojnë këte akt themelimi të shoqërisë "VEGA ENGINEERING" Sh.p.k. mbi bazën e këtyre principeve:

**NENI 1**  
**FORMA DHE EMRI**

**1.1** Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K dhe i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributeve të ortakëve në kapitalin themeltar. Emri i shoqërisë "VEGA ENGINEERING" Sh.p.k.

**NENI 2**  
**BAZA LIGJORE**

**2.1** Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9901. datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe në përputhje me legjisacionin Shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

**NENI 3**  
**SELIA**

**3.1** Selia e shoqërisë është në adresën: Mëzez, Njësia Administrative Kashar në pasurinë nr 186/17/1 në Zonën Kadastrale 2679, Tiranë.

Në adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

**NENI 4**  
**KOHËZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË**

**4.1** Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likuidimi me vendim të Asamblesë së Ortakeve, sipas rasteve të parashikuara në ligj.

## **NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

**5.1** Shoqëria “**VEGA ENGINEERING**” Sh.p.k është e fokusuar në mirëmbajtjen, monitorimin dhe kontrollin teknik në mënyrë periodike të impianteve fotovoltaikë të të gjitha madhësive. Shoqëria kryen riparime dhe ofron asistencë teknike për pajisje dhe impiante duke ofruar shërbime mirëmbajtje për çdo lloj sektori industrial.

## **NENI 6 KAPITALI THEMELTAR**

**6.1** Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 ALL (njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 2 pjesë. Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

<b>1. BRUNO PAPAJ</b>	<b>50,00%</b>	<b>50.000,00 LEKË</b>
<b>2. PHILIPP KORONOWSKI</b>	<b>50,00%</b>	<b>50.000,00 LEKË</b>

**6.2** Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer tërësisht dhe është depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

## **NENI 7 AKTET E SHOQERISE**

**7.1** Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8 ORGANET DREJTUESE**

- 8.1** Organet drejtuese të shoqërise do të janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori.
- 8.2** Shoqëria mund të emërojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar Administratorët e shoqërisë “**VEGA ENGINEERING**” Sh.p.k, ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numër.
- 8.3** Përveç organeve të parashikuara më sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese në aktet e krijuar të këtyre organeve do të përcaktohet kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.
- 8.4** Administratori i shoqërisë **Z.Dornaldo Naka** është emëruar për një periudhe 5 (pesë) vjeçare. Në rast se në vijim do të emërohen administratorë të tjera ata mund t'i ushtrojnë kompetencat e tyre bashkarisht ose veç e veç.

## **NENI 9 DISPOZITA TË FUNDIT**


- 9.1** Çdo mosmarrëveshje a konflikt në lidhje me themelin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet, kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

**9.2 Ky Akt-themelimi është hartuar me 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën Shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njejtë ligjore.**


**Tiranë, 09/01/2023**

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË  
VEGA ENGINEERING SH.P.K**

**BRUNO PAPAJ**



**PHILIPP KORONOWSKI**



**DORNALDO NAKA**

